



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Nr. 060/04-22235 dt. 11/06/2026

PROCESVERBAL

I mbledhjes së pestë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 25.05.2026, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KPF-së: Burim Bujupi, kryesues i Kuvendit, Fitore Morina-Hoxha (PDKRIJ), Selman Çallapeku (PDKRLL), Pajtim Berisha (PDK), Arigon Sinani (PDK), Egzona Tërdevci (VV) Arbër Halilaj (BD).

Të pranishëm ishin edhe: Arben Shala nënkryetar i Komunës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Burim Bujupi**, kryesues i Kuvendit.

RENDI I DITËS:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politike dhe Financa i dt. 21.04.2026.
2. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, pasi përshëndeti të pranishmit, hapi diskutimin për rendin e ditës.

Egzona Tërdevci, ngriti çështjen e një propozimi të bërë para tre muajsh lidhur me mbështetjen financiare të njëhershme për fëmijët me sindromën Down. Ajo pyeti nëse komuna ka bërë ndonjë analizë financiare apo nëse ky propozim nuk është marrë parasysh fare.

Nënkryetari i Komunës, Arben Shala u përgjigj se, duke parë gjendjen aktuale financiare, nuk besoi se kjo është e mundur për momentin, mirëpo mbetet që çështja të shihet dhe të diskutohet më hollësisht me Drejtorin e Financave.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, e hodhi në votim rendin e ditës për t'i rekomanduar Kuvendit pikët e propozuara.
Për votuan 7, abstenime 0, kundër 0. Rendi i ditës aprovohet pa ndryshime.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e parë. Pika (1) Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i dt. 21.04.2026. Pasi nuk pati diskutime, pika u hodh në votim. Për votuan 7, abstenime 0, kundër 0.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës.
Pika (2) Të ndryshme.

Egzona Tërdevci, theksoi se kishte një propozim, të cilin e kishte paraqitur edhe gjatë mandatit të kaluar, por që nuk ishte marrë parasysh. Znj. Tërdevci sqaroi se pika "Të ndryshme" vazhdimisht konsumohet me pyetje dhe përgjigje për drejtorët e drejtorive.

Duke u bazuar në rendet e ditës të komunave të tjera, ajo vuri në dukje se ato e kanë këtë çështje si pikë të veçantë të rendit të ditës. Sipas znj. Tërdevci kjo praktikë do t'u shërbente edhe asamblistëve për t'i adresuar pyetjet më mirë, pasi ndodh që nganjëherë drejtorët të mund të jenë të papërgatitur. Në fund, znj. Tërdevci i propozoi kryesuesit që të bisedojë me kryetarin e komunës, në mënyrë që kjo pikë ("Pyetje dhe përgjigje për drejtorët") të përfshihet në rendin e ditës, jo në fillim apo në fund, por diku në mesin e seancës.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi mbështeti diskutimin, duke përmendur se këtë praktikë e ka parë edhe në një seancë të Kuvendit Komunal të Prishtinës.

Nënkryetari i Komunës, Arben Shala, njoftoi anëtarët se pesë vendime nga mbledhja e kaluar nuk janë në përputhje me ligjin dhe si rrjedhojë duhet të shfuqizohen.

Arigon Sinani, kërkoi që në mbledhjen e rregullt të Kuvendit të shtohet një pikë shtesë:
Propozim-vendim për formimin e komisionit për verifikimin e të gjitha lejeve ndërtimore të lëshuara në Komunën e Drenasit nga viti 2017 deri në vitin 2026. Gjithashtu, ai kërkoi një raport financiar për klubin futbollistik "KF Feronikeli" për të njëjtën periudhë (nga viti 2017).

Pajtime Berisha, pyeti se përse është pezulluar aktiviteti i prokurimit për realizimin e projektit për rregullimin e rrethojave të varrezave në Poplek dhe Fushticë.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, prezantoi kërkesën e znj. Tërdevci që rendit të ditës në Kuvend t'i shtohet edhe një pikë shtesë. "Pyetje dhe përgjigje për drejtorët e drejtorive". Gjithashtu, kryesuesi paraqiti kërkesën e z. Sinani për formimin e një komisioni për verifikimin e të gjitha lejeve të ndërtimit të lëshuara në Komunën e Drenasit nga viti 2017 deri në vitin 2026. Lidhur me raportin financiar të klubit "Feronikeli", kryesuesi theksoi se anëtarët e Kuvendit kanë të drejtë të kërkojnë raport vetëm për vlerën e subvencionuar nga komuna. kryesuesi sqaroi se, ndonëse para aplikimit për subvencione Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport DKRS-ja, kërkon raport kthyes financiar për klubet e subvencionuara për vitin paraprak, Komuna nuk ka të drejtë ligjore të kërkojë raporte për sponsorizimet nga bizneset apo personat individualë. Sipas tij, të gjitha klubet i nënshtrohen auditimit të brendshëm dhe raportojnë pranë organeve kompetente.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, deklaroi se pasi nuk pati diskutime të tjera, mbledhja konsiderohet e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 10:20.

Procesmbajtësja: Fakete Hoti

Lekturoi: Nikelinda Bujupi

Kryesuesi i Kuvendit

Burim Bujupi

